URDHËR
Nr.328, datë 22.11.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr.10 465 datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", nenit 18 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve".
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, drejtoritë rajonale të bujqësisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
3. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli